



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1160/4 Prot.

Durrës, më 7.07 2023

VENDIM

Nr. 38, datë 7.07 2023

**"MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË PËRBASHKËT
(DIPLOMË E DYFISHTË), NË CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE,
"DOKTORATË" NË "SHKENCA EDUKIMI" TË UNIVERSITETIT
"ALEKSANDËR MOISIU", Durrës ME UNIVERSITETIN PEDAGOGJIK,
KRAKOV, POLONI**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.41 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" i ndryshuar me VKM nr. 879, datë 16.02.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, në udhëzimin Nr.1, datë 14.01.2020 "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", të Statutit të Universitetit, të Rregullores së Universitetit, të tabelës bashkëlidhur, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e hapjes së programit të studimit të përbashkët (diplomë e dyfishtë) në Ciklin e Tretë të Studimeve, "Doktoratë" në 'Shkenca Edukimi' të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës me Universitetin Pedagogjik Krakov, Poloni, pranë Departamentit të Pedagogjisë, në Fakultetin e Edukimit.
2. Miratimin paraprak të tarifës së programit të studimit sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Bordit të Administrimit për miratim e tarifës përkatëse.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore të Fakultetit të Edukimit
 - Drejtuesi i Njesisë Bazë

K R Y E T

Prof. Dr. Kseanela **SOTIROFSKI**

